

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	“Construmax” Sh.p.k. me adresë në Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	21.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: 19.10.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **“Construmax” Sh.p.k. me adresë në Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RENOVIMI I STACIONIT TË AUTOBUSËVE DHE VENDOSJA E KABINAVE**, me Numër të prokurimit: 623-20-3186-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-029-5-2-1, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **“Construmax” Sh.p.k. me adresë në Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RENOVIMI I STACIONIT TË AUTOBUSËVE DHE VENDOSJA E KABINAVE**, me Numër të prokurimit: 623-20-3186-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-029-5-2-1, kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues, të datës: 15.10.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **RENOVIMI I STACIONIT TË AUTOBUSËVE DHE VENDOSJA E KABINAVE**, me Numër të prokurimit: 623-20-3186-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-029-5-2-1.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: “**Construmax**” Sh.p.k. me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RENOVIMI I STACIONIT TË AUTOBUSËVE DHE VENDOSJA E KABINAVE**, me Numër të prokurimit: **623-20-3186-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-20-029-5-2-1**, kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues, të datës: **15.10.2020**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **19.10.2020**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR NR 1.

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje lidhur me Nenin 61, i LPP-së – Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.

Sipas B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, Neni 3 thotë:

Neni 3 Informatat e përgjithshme

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Grup i Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë, nuk e plotëson asnjë nga kriteret për tu konsideruar Oferta me çmim jo normalisht të ulët dhe kjo është arsyeje pse nuk kemi kërkuar sçarim nga Grup i Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë, ku gjeni të bashkangjitur tabelarin:

Kushti I pare kemi 11 oferta			plotësohet sepse janë pranuar 3 oferta te përgjegjshme
1	150,704.71	177,831.56	
2	120,543.58	142,241.42	Oferta 2 ma I lire
3	168,325.48	194,002.24	
4	116,621.20	137,613.02	Oferta 1 ma I lire
5	134,532.83	158,748.23	
6	148,728.81	175,500.00	
7	152,123.76	185,516.79	
8	156,101.33	184,199.56	
Totali	1,147,681.70	1,355,652.82	
Mesatarja (totali B12/ 11)	104,334.70	123,241.17	
Kushti i dyte 30 %	80,257.46	94,800.90	çdo oferte nen ketë çmim (125.871.56) plotëson ketë kusht, e qe ne rastin konkret asnjë oferte
Kushti i trete 10 %	109,585.07	129,310.38	çdo oferte nen ketë çmim (129,310.38) plotëson ketë kusht, e qe ne rastin konkret asnjë oferte. Edhe sikur ndonjë oferte tjetër te plotësonte kushtin e trete 10%, nuk do te merrej parasysh sepse 30% nuk e ka plotësu asnjë oferte.

Pas kthimit të këtij aktiviteti të prokurimit në rivlerësim sipas vendimit të OSHP-së me nr. 629/20, të datës: 09.10.2020, kemi qenë të obliguar të kërkojmë sqarime shtesë, ku i kemi kërkuar të gjitha sqarimet shtesë të pretehuara nga ana juaj, vetëm për çmimet jo-normalisht të ulëta në pozicionet për tre Operatorë Ekonomik të cilët kanë vazhduar vlefshmërinë e tenderit. Në Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderin jo-normalisht të ulët, të dërguar me datë: 13.10.2020, ne si AK kemi cekur: *4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ulët, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbatim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".*

Kërkesa e AK-së ka qenë: **Konform nenit 61 të LPP kërkojmë nga ju të na jepni shpjegime detale se si do të realizoni këto pozicione.**

Ju lutem që në deklaratën tuaj të specifikoni se si do të mund të realizoni këto pozicione në terren me këto çmime të ulëta, dhe na shpjegoni ju lutem detalisht për secilin pozicion. Grup i Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, është përgjigjur në kërkesën tonë duke dhënë shpjegim detal se si do të realizon këto pozicione, duke dhënë përgjigje për secilin pozicion detalisht.

Lidhur me pretendimin të Operatori Ankues, duke cekur se: Gjithashtu është për tu habitur se si keni mundur të rekomandoni për kontratë këtë OE, pasi që në sqarimet e ofruara e ka cekur se ka disa bashkëpunëtor që do të angazhojnë në këtë projekt dhe është bazuar në ofertat e tyre gjatë ofrimit të sqarimeve shtesë, ndërsa siç e dini edhe ju OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij nuk ka prezantuar fare nënkontraktorë. Andaj duke u bazuar në faktin e lartcekur shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm në bazë të dispozitave të nenit 30 të LPP-së i cili e parasheh qartë se: *Tenderuesi duhet të tregojë në tenderin e tij ndonjë pjesë të kontratës që ai ka për qëllim të nënkontrakttojë palëve të treta dhe secilin nënkontraktues të propozuar. Një indikator i tillë nuk ka efekt mbi detyrimin kontraktual nga tenderuesi në lidhje me autoritetin kontraktues apo të tjerët. Autoritetet kontraktuese mund të sigurojnë, ku ata e konsiderojnë atë si të nevojshme, për pagesat direkte për nënkontraktorët, andaj duke u bazuar në nenin e lartcekur OE i rekomanduar për kontratë është dashur të shpallet i papërgjegjshëm sepse nuk i ka prezantuar në ofertën e tij nënkontraktorët siç e ka cekur në sqarimet shtesë.*

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, në përgjigje të tij të informatave për tenderin abnormalisht të ulët ka cekur për një pozicion: *Sa i përket pozicionit 2.11.a. ju sqarojmë se ne si kompani, Sa i përket pozicioneve të njejtë të përshkrimit të çmimeve për zhvendosjen dhe vendosjen e dritareve, ne kemi kompaninë që kemi bashkëpunim shumëvjeçar ku në ofertën e tyre për projektin e lartëcekur demolimi dhe zhvendosja e tyre është e llogaritur me çmimin e ofertes të furnizimit dhe montimit të tyre ngase nga bashkëpunimi i ngushtë mes kompanisë tone dhe kompanisë së prodhimit dhe montimit të dritareve dhe dyerve, na është bërë kjo ofertë, andaj kemi vendosur çmimin të demolimit 0.05€, Ku se ne si O.E. jemi të gatshëm të marrim përsipër ekzekutimin e të gjitha punëve për projektin e lartëcekur dhe zotohemi se implementimi do të bëhet sipas përshkrimeve në pozicione.*

Në sqarimin e tij ceket se ka marrë ofertën nga kompania prodhuese para aplikimit të tenderit, pasi që OE i rekomanduar për kontratë nuk është prodhues i dyerve dhe dritareve, por ka marrë ofertë financiare nga kompania prodhuese, andaj pretendimi i juaj është i pabazuar pasi që këtu nuk kemi të bëjmë me nën kontraktim.

Po ashtu vlen të ceket se në Raportin e Ekspertit Shqyrtues të OSHP-së, me nr. 629/20, e datës: 22.09.2020, duke cekur se:

Eksperti shqyrtues sqaron se nuk është plotësuar asnjëri nga kushtet e lartcekura për të kërkuar sqarime, andaj AK ka respektuar këtë paragraf të rregullave për tender jo normalisht të ulët dhe ka vepruar në harmoni me dispozitat e nenit 61 të LPP-së dhe me Rregullat për tenderët jo normalisht të ulët, njëdhimisht ky pretendim i OE ankues nuk qëndron.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR NR 2.

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje lidhur me *Nenin 59 i LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve*, duke cekur se: “OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka kalkuluar fare TVSH si është kërkuar në paramasë pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka vendosur çmimin në Totali PA TVSh dhe Totali me TVSh me vlerë të njëjtë 137,613.02 €, ndërsa nëse do të ishte vendosur TVSH-ja atëherë i bie që çmimi total i ofertës së OE të rekomanduar për kontratë është 162,383.36 €, çmim ky që automatikisht tregon se ky OE është më i shtrenjtë se ne dhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.”

Ju sqarojmë se edhe pas rishqyrtimit të dokumentacioneve lidhur me këtë kërkesë, Grupi i Operatorëve Ekonomik fitues nuk ka gabimet aritmetike në bazë të pretendimeve, dhe pretendimet të juaja janë pa mbështetje ligjore dhe faktike.

Sipas Opinionit të KRPP-së ku thotë: *Si rrjedhojë, nëse në ofertën e OE-së nuk ka mospërputhje në mes çmimit njësi dhe totalit, por ka gabime vetëm në përcaktimin e normës së TVSH-së nga ajo që e përcakton ligji mbi TVSH-në, opinioni i KRPP-së është se AK nuk mund të klasifikojë këtë si gabim në llogaritje +/- 2% duke u bazuar në paragrafin 3 të nenit 59 të LPP-së, sepse kjo është një situatë tjetër nga ajo që rregullon paragrafi në fjalë, prandaj AK do të veprojë në përputhje me interpretimin e publikuar në ueb-faqen e KRPP tek "Pyetjet e shpeshta" Pyetja me Nr. 46 dhe të marrë një vendim në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj.*

Po ashtu tek Procesverbalin e hapjes së ofertave, ku Grup i Operatorëve Ekonomik e ka të ndarë, çmimin pa TVSh dhe çmimin me TVSh, ku vlera totale pa TVSh është: 116,621.20 €, ndërsa vlera totale me TVSh është: 137,613.02 € dhe jo sipas pretendimit tuaj në vlerë me TVSh prej: 162,383.36 €.

Po ashtu vlen të ceket se sipas vendimit të OSHP-së, me nr. 629/20, e datës: 22.09.2020, duke cekur se:

Sa i përket pretendimit të OE ankues "CONSTRUMAX" Sh.p.k – Suharekë, se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk ka kalkuluar fare TVSH-në në para masë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në para masën e ofruar nga grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë ka ofruar tabelën me përshkrimi teknik i punimeve, projekti, detalet, skemat grafike dhe specifikimet teknike, po ashtu në tabelë është ofruar: Njësia matëse, Sasia, Çmimi për njësi (€), Çmimi total (€), pra në tabelë mungon rubrika ku është dashur të jetë TVSH-ja. Në fund të tabelës thuhet që TVSH-ja është llogaritur në pozicione mirëpo kjo nuk qëndron. Pra, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në procesverbalin e hapjes së ofertave gjendet çmimi pa TVSH dhe çmimi total me TVSH, dhe çmimi total është i njëjtë me çmimin në Njoftimin për vendimin e AK-së. Andaj, meqë ky

Faqe 9 nga 10

gabim është evident mirëpo nuk e ndryshon çmimin përfundimtar të rekomanduarit për kontratë pretendimi ankimor nuk qëndron.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR NR 3.

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje lidhur me Nenin 69, i LPP-së – Gjendja Ekonomike dhe Financiare, duke cekur se: *"Konsiderojmë që ju si AK keni bërë shkelje esenciale pasi që keni shpallë një OE fitues ku lideri i konzerciumit nuk ju ka dorëzuar deklaratat vjetore të deklaruara në ATK sipas kërkesës së FDT pasi që ju si AK nuk keni pasur dëshmi që lideri i konzerciumit ka deklaruar tatimet apo qarkullim në AKT edhe pse i njëjti ka munde të ju ofroj vërtetim tatimore të ATK edhe nëse ai nuk ka bërë deklarime në ATK"*.

Ju sqarojmë se edhe pas rishqyrtimit të dokumentacioneve lidhur me këtë kërkesë, Grupi i Operatorëve Ekonomik fitues e ka plotësuar këtë kërkesë konform dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe se pretendimet e juaja janë pa mbështetje ligjore dhe faktike.

Në Njoftim për kontratë dhe në Dosjen e tenderit ne si AK nuk kemi përdorur Nenin 27.4 Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e operatorëve ekonomikë duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-së. Kjo do të thotë se AK-se mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave nga njeri anëtar i grupit të OE.

Andaj kjo kërkesë është plotësuar nga Grup i Operatorëve Ekonomik, pasi që në Njoftim për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit nuk është ndarë përqindja për përmbushjen e kërkesës mbi gjendje Ekonomike dhe Financiare sipas pretendimit tuaj.

Po ashtu vlen të ceket se në Raportin e Ekspertit Shqyrtues të OSHP-së, me nr. 629/20, e datës: 22.09.2020, duke cekur se:

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3 - OE ankues pretendon që lideri i konzorciumit i GOE-ve të rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e FDT-se, lidhur me deklaratat tatimore vjetore.

Eksporti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *"Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit, në vlerë jo më pak se 430,000.00 €".* Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: *"Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit".*

Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e DT-së nuk ka qenë që lideri i konzorciumit duhet të ofroj deklaratat tatimore vjetore, në rastet të tilla kur nuk është e përcaktuar në DT nuk obligohen të gjithë anëtarët e konzorciumit të ofrojnë deklaratat tatimore. Shih nenin 27.3 të RROUP ku thot:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashituar nga OE "CONSTRUMAX" Sh.p.k - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i stacionit të autobusëve dhe vendosja e kabllave", me nr. të prokurimit: 623-20-3166-S-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) KK Rahovec.

Secili anëtarë i grupit duhet të përmbush kërkesat e përshatshmërisë, neni 65 i LPP-se.

Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të LPP-se do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Andaj ky pretendim i OE ankues nuk qëndron.

Po ashtu gjeni të bashkangjitur Deklarata nga ATK, nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, si shembull vetëm nga një anëtar i konzorciumit për vitin 2019, ndërsa i kemi në dispozicion edhe tjera:



CD FORMULARI I DEKLARIMIT VJETOR DHE PAGESES PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE

[1] Periudha e Deklarimit: 2019	[2] NIF: 810199093	 NFA2H8020759741V
[4] Emri i biznesit: SINANI - ING SH.P.K.		
[5] Adresa e biznesit: Bul. i Dëshmorëve, 72 Kati 1-në	[5a] Kodi primar i veprimtarisë: 4120	
[6] Emri i kontaktues: Haradin Krasniqi	Telefoni: 044/365 -652	

[10] Të ardhurat neto (humbja) sipas DF: [10] 71,223.74

Rregullimet në të ardhurat

[11] Të ardhurat me Burim të Huaj (Tabela A)	[11] 0.00
[12] Anketimi i Boncheve të Keqija (Tabela B)	[12] 0.00
[13] Fitimet Kapitale (Tabela C)	[13] 1,694.92
[14] Dividendet (Tabela D)	[14] 0.00
[15] Të ardhura/fitime të tjera (Tabela E)	[15] 0.00
[16] Rregullimi total në të ardhura (mbledh kutijat [11] deri [15])	[16] 1,694.92
[17] Fitimi (humbja) pas rregullimit në të ardhura (kutia [10] + kutia [16])	[17] 72,918.66

Rregullimet në shpenzime (shumica e numrave negativë të treguar në kllapa - përpos kutisë 24)

[18] Shpenzimet e pazbatishme (Tabela F)	[18] -32.92
[19] Shpenzimet e përfaqësimit (Tabela G)	[19] 0.00
[20] Fondet Rezerve (Tabela H)	[20] 0.00
[21] Paguesat për Personat e Lidhur (Tabela I)	[21] 0.00
[22] Amortizimi (Tabela J)	[22] 0.00
[23] Zhvlerësimi (Tabela K)	[23] 0.00
[24] Lejimi special për asetet e reja (Tabela L)	[24] 0.00
[25] Humbja kapitale (Tabela C)	[25] 0.00
[26] Shpenzime të tjera (Tabela M)	[26] 0.00
[27] Rregullimi total në shpenzime (mbledh kutijat [18] deri [26])	[27] -32.92
[28] Fitimi (humbja) e biznesit pas rregullimit në shpenzime (kutia [17] - kutia [27]) (Kur kutia 27 është në kllapa mbledh numrat e plotë)	[28] 72,951.58
[29] Kontributet bamirese (bashkëgjyri deftesat) (10% të vlerës së tatueshme, si dhe lejimi shtesë deri në 10%, nëse parashihet me ligje të veçanta në Kosovë) nga kutia 28	[29] 0.00
[30] Humbjet e bartura (referoju doracakut)	[30] 0.00
[31] Mbledh kutiat [29] dhe [30]	[31] 0.00
[32] Fitimi i azhustuar (kutia [28] - kutia [31])	[32] 72,951.58
[33] Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (Nëse kutia [32] është fitim, shumëzo me 10%. Nëse kutia [32] është humbje, vendos 0)	[33] 7,295.16

Vetëm për Kompanitë e Sigurimeve

[34] Primet bruto për periudhën tatimore	[34] 0.00
[35] Tatimi në të Ardhurat e Korporatave për Kompanitë e Sigurimeve ([34] * 5%)	[35] 0.00
Rimbursimi ose Obligimi	
[36] Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (mbledh shumën në kutinë [33] me kutinë [35] sipas situatës suaj)	[36] 7,295.16
[37] Kreditimi tatimor nga shtetet e huaja (Tabela O)	[37] 0.00
[38] Tatimi i mbajtur në interes, të Drejtat Pronësore dhe Qira nga paguesit rezident (Tabela P - bashkëgjyri certifikatat)	[38] 0.00
[39] Totali i krediteve për periudhë [37] + [38]	[39] 0.00
[40] Kutia [36] minus [39]	[40] 7,295.16
[41] Këstet e paguara (Tabela Q)	[41] 4,531.20
[42] Obligimi tatimor para zbritjeve për sponsorizim (Vlera e bartur nga kutia [36])	[42] 7,295.16
[43] Zbritjet për sponsorizim në fushën e sportit (max. 30% e kutisë [42])	[43] 0.00
[44] Zbritjet për sponsorizim në fushën e kulturës dhe reutë (max. 20% e kutisë [42])	[44] 0.00
[45] Totali i zbritjeve për sponsorizim ([43] + [44], max. 30% e kutisë [42])	[45] 0.00
[46] Tatimi për pagesë me këtë formularë ([40] - [39] - [41] - [45])	[46] 2,763.96

Shënime:
a) Nëse rezultati në kutinë [46] është pozitiv (+) ju keni një shumë kolektive për pagesë, e cila duhet të vendoset në kutinë [47].
b) Nëse rezultati në kutinë [46] është negativ (-) ju mund të kërkonit rimbursim ose primatim kutinë [48].
c) Nëse shuma e vendosur në kutinë [46] është më e vogël se shuma në dispozicion për të kërkuar rimbursim, vlerën shume e rimbursimit korrespondent pagesë [46], e cila mund të përdoret si limit përshkrim për vitin vijues, si dhe për zbritjen e detyrimeve tatimore në vitin vijues dhe kontributet bamirese.

[47] Obligimi	2,763.96
[48] Kërkesa për Rimbursim	0.00
[49] Emri i bankës	
[50] Numri i llogarisë	
[51] Mbjajtësi i llogarisë	

DEKLARATA E TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE SIPAS AKTIVITETEVE

Të ardhurat bruto lidhur me aktivitetet operative		
[60] Të ardhurat bruto	[60]	1,524,909.29
Shpenzimet e lidhura me aktivitetet operative:		
[61] Stoku në fillim	[61]	269,436.00
[62] Blerjet apo kostoja e prodhimit	[62]	1,130,083.92
[63] Totali ([61]+[62])	[63]	1,399,519.92
[64] Stoku në fund	[64]	221,277.91
[65] Kostoja e mallrave të shitura ([63]-[64])	[65]	1,178,242.01
[66] Bruto fitimi ([60]-[65])	[66]	346,667.28
[67] Pagat bruto	[67]	92,038.80
[68] Shpenzimet për zhvlerësim dhe amortizim (nuk përfshihen në koston e mallrave)	[68]	42,724.22
[69] Shpenzimet e shitjes	[69]	0.00
[70] Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative (nuk përfsh. në koston e mallrave)	[70]	127,477.06
[71] Shpenzime për hulumtime dhe zhvillim	[71]	0.00
[72] Shpenzimet tjera operative	[72]	0.00
[73] Totali i shpenzimeve operative ([67] deri [72])	[73]	262,240.08
[74] FITIMI (HUMBJA) NGA AKTIVITETET OPERATIVE ([66]-[73])	[74]	84,427.20
AKTIVITETET JO-OPERATIVE		
[75] Të ardhurat tjera	[75]	2,474.37
[76] Shpenzimet tjera	[76]	15,677.83
[77] FITIMI (HUMBJA) NGA AKTIVITETET JO-OPERATIVE ([75]-[76])	[77]	-13,203.46
[78] Të ardhurat neto ose humbja ([74]+[77])	[78]	71,223.74

Të ardhurat neto në kutinë 78 bartet në kutinë 10 të TAK

Bashkangjit deklaratën për TAK

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR NR 4.

Konsiderojmë që ju si AK keni bërë shkelje esenciale pasi që keni shpall fitues kompania i cili nuk ka plotësuar të gjitha kriteret dhe tek pjesa e kapaciteteve teknike dhe profesionale sipas DT. **Konzerciumi ka paraqit një Menaxher të Projektit i cili nuk e ka të noterizuar diplomën** edhe pse ju është bashkangjitur një letër në faqen e më poshtme e noterit, mirëpo ajo letër e noterizuar nuk përmban asnjë të dhënë që dëshmon që kjo diplomë është kopje e noterizuar dhe supozojmë që Diploma është prezantuar si kopje e panoterizuar pasi që nuk ka asnjë vullë noterizuese në diplomë e as ndonjë dokument që dëshmon që diploma është kopja nga diploma origjinale.

Ju sqarohet se edhe pas rishqyrtimit të dokumentacioneve lidhur me këtë kërkesë, Grupi i Operatorëve Ekonomik fitues e ka plotësuar këtë kërkesë konform dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe se pretendimet e juaja janë pa mbështetje ligjore dhe faktike.

Grup i Operatorëve Ekonomik i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar këtë kriter, pasi që në ofertën e tij ka dorëzuar Diplomën e Inxhinierit, po ashtu e ka dorëzuar Kontratën e punës të noterizuar me Inxhinierin në fjalë, si Menaxher i Projektit, duke cekur te Neni 1 i kontratës: *Punëtori themelon marrëdhënie të punës të punëdhënësi në afat të pacaktuar.*

Në kërkesën e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë është:

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet të ketë në listën të paktën këtë staf profesional

2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit.

Dëshmia 2: • Diplomat përkatëse – Kopje;

Gjeni te bashkangjitur Diplomën e Inxhinierit:

REPUBLIKA SOCIALISTE FEDERATIVE E JUGOSLLAVISË
Социјалистичка Федеративна Република Југославија
REPUBLIKA SOCIALISTE E SERBIË
Социјалистичка Република Србија
KRAHINA SOCIALISTE AUTONOME E KOSOVËS
Социјалистичка Аутономна Покрајина Косово



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
Универзитет у Приштини

FAKULTETI TEKNIK I PRISHTINËS
Технички факултет у Приштини

DIPLOMË

ДИПЛОМА

E PËRGATITJES SUPERIORE SHKOLLORE
О високој школској спреми

REKTORI I UNIVERSITETIT DHE DEKANI I FAKULTETIT TEKNIK TË UNIVERSITETIT TË
Ректор Универзитета и декан Техничког факултета Универзитета у Приштини, спојем потписима и печатом
PRISHTINËS, ME NËNSHKRIMIN E TYRE DHE ME VULËN E UNIVERSITETIT, VËRTETOJNË
Универзитета, потврдују да је
SE

Emin Hajdin Dragusha

I-E LINDUR MË 01.01.1962 NË BËKRIÇË TË CRËKING I-E REGJISTRUAR NË VITIN
рођен-а уписан-а школске
SHKOLLOR 1980/81 MË 08.02.1988 I DHA TË GJITHA PROVIMET E PARAPARA
године дана положио-ла све прописане испите на
PËR TË MBAYUAR FAKULTETIN TEKNIK, SEKSIONIN E ARDËTIMITARISË
Техничком факултету одсек за ардетимтарисе
DREJTIMIN KONSTRUKTIV ME NOTË MESATARE GJATË STUDIMEVE 6,92
смер са просечном оценом у току студија
NË PROVIMIN E DIPLOMËS 9 DHE I PLOTËSOI KUSHTET E PARASHIKUARA
на дипломском испиту и испунио-ла све предвиђене услове
PËR TË MARRË PËRGATITJEN SUPERIORE SHKOLLORE.
за стицање високе школске спреме.
MBI KËTË BAZË TË PËRMENDURIT I JEPET KJO DIPLOMË, MË TË CILËN I FITON TË
На основу горе наведеног се ова диплома којом стицање права предвиђена законом као и стручни назив
DREJTAT QË PAKASHIHEN ME LIGJ SI DHE TITULLIN PROFESIONAL

inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë

PRISHTINË, MË 30. 09. 1988 Nr. 2972
Приштина, Бр.

DEKANI
Декан
dr. Cemal Dolicanin prof. ord.

REKTORI
Ректор
dr. Bozhidar Collaković prof. ord.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit